



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	14.07.2017
REFERENC-Ë:	156/4
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
GA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Rekomandimin-Refuzimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturorë nr.14/2017 të dt.30.06.2017 për lëndën e Nue Lekajt Nr.04-070/05-11260 për ndërtimin e objektit – afarist hoteljerik.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Rekomandimit.



INSTITUTI KOSOVËR PËR MBROJTJEN E PËRVEJË KULTURËS
INSTITUT ZA ZAŠTITU SPOMENIKA KULTURE KOSOVO
THE KOSOVO INSTITUTE FOR CULTURAL MONUMENT PROTECTION
Nr. 342 Prishtinë 12.07.2017
PRISHTINË

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sports
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve / Kosovo Institute for Protection of
Monuments / Institut Kosova za Zastitu Spomenika

DATE/A:	30.06.2017
REFERENC-Ë:	14/2017 – Takimi i katërbëdhjetë
PËR/ZA/TO:	Z. Agim GERGURI – U.D. Drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.
CC:	Z. Bislim BISLIMI – Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit / DL – MKRS, anëtar i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM; Znj. Zana LLONÇARI OSMANI – Zyrtare e Lartë në Departamentin e Trashëgimisë Kulturore – MKRS, anëtare e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM;
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Znj. Teuta SELMANAJ – Zyrtare Ligjore në IKMM, përgjegjëse për mbështetjen administrative të punës së Komisionit
NGA/OD/FROM:	Znj. Merita AUGUSTININRECAJ – Kryesuese e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimet e Komisionit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave / projekteve: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Prishtinë, Gjilan dhe Prizren.

I nderuar Drejtor z. Gërguri,

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore (në tekstin e mëtejme Komisioni) i emëruar me Vendimin Nr. 01/2016 të datës 13.04.2016, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin tjetër Nr. 52/2016 të datës 04.10.2016 me Nr. të protokollit 376, i ndryshuar dhe plotësuar, ka zhvilluar takimin e trembëdhjetë (13) punues me datë 08.06.2017, ku janë shqyrtuar kërkesat dhe projektet e Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK)-Prishtinë, Gjilan dhe Prizren. Janë dhënë rekomandimet si në vijim:

Rreth kërkesës Nr. 2. QRTK - Prizreni:

2. Nue Lekaj nga Prizreni ka parashtruar kërkesë për ndërtimin e objektit - afarist hotelerie në ngastrën kadastrale me nr. 3204 - 0. Objekti ekzistues është P+0, ndërsa e re planifikohet të jetë B+P+2. Objekti i lartcekur gjendet në zonën e VIII-të sipas planit të konservimit ku etazhiteti i lejuar është P+2 (lartësia maksimale deri te streha është 9.5m) dhe për ndërtim mund të shfrytëzohet deri 60% e sipërfaqes së parcelës. Në afërsi të parcelës për ndërtim gjenden objektet si Trafostacioni i vjetër, Kompleksi i Kishës Katolike dhe Hani familjes Kovaç që janë në listën e MKRS-së, Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme (10.10.2016 - 10.10.2017). Objekti është në rrugën "Hysen Rexhepi". Gjatë shqyrtimit të projektit dhe analizimit të kontekstit urban të parcelës ku kërkohet të ndërtohet, Komisioni vëren se, projekti i propozuar, tejkalon kriteret për ndërtim në zonat mbrojtëse të monumenteve në afërsi të tyre. Komisioni vlerëson se lartësia e objektit të propozuar për ndërtim dukshëm dominon kuadrin vizuel të monumenteve në afërsi.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese - Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka vendosur si më poshtë:

1. Refuzohet Projekt propozimi për ndërtimin e objektit-afarist hotelerie në ngastrën kadastrale
2. Njohet pala se munde të sjellë një projekt propozim tjetër ku lartësia e lejuar është sa ndërtesa e Hanit të Kovaçëve.